

DOKUMENTET PËR APLIKIM

- a) Kërkesa, në formë autobiografie profesionale, e cila të përmbajë dhe të dhëna për licencën e disponuar më parë (kopje të licencës që disponon dhe/ose numër të vendimit të Komisionit, me të cilin është miratuar licenca);
- b) karta e identitetit;
- c) dy fotografi 3x4 cm të vlerësuesit;
- ç) diplomë universitare;
- d) certifikatë për kryerjen e kursit pasuniversitar;
- dh) listë të objekteve të vlerësuara;
- e) Vetëdeklarimi, ku individi të deklarojë se një dhe angazhohet të zbatojë kushtet, rregullat dhe standardet e vendosura nga dispozitat në fuqi për ushtrimin e profesionit në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme dhe, në mungesë të tyre, t'u referohet standardeve evropiane të vlerësimit. Gjithashtu, të deklarojë se nuk është i dënuar nga organet e gjyqësorit në lidhje me ushtrimin e profesionit të vlerësimit;
- ë) Vërtetim, nga organet tatimore, për shlyerjen nga individi të të gjitha detyrimeve tatimore, të lëshuar jo më vonë se 1 muaj nga aplikimi (vërtetim nga drejtoria rajonale tatimore dhe nga drejtoria e taksave dhe tarifave vendore pranë bashkisë respektive).

- Pagesa e tarifës.

Dorëzimi, pranimi i aplikimit

- 1. Kërkesa për licencë dhe dokumentet shoqëruese të saj, sipas kësaj rregulloreje, dërgohen nëpërmjet sistemit informatik të integruar për shërbimet e licencimit në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme, që funksionon pranë portalit unik të shërbimeve qeveritare e-Albania.
- 2. Dokumentet për licencë duhet të jenë:
 - a) origjinale ose fotokopje të noterizuara;
 - b) në gjuhën shqipe ose të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar;
 - c) për rastet e dokumenteve të huaja, kopje të vërtetuara nga një autoritet publik i juridiksionit të huaj (zyrtar/noter). Është detyrim të vërtetohet ekzistenca e tyre si zyrtarë apo noterë, nëpërmjet legalizimit apo apostilimit, sipas ligjeve në fuqi dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.
- 3. Pagesa e tarifës për përfitimin e licencës kryhet ose nëpërmjet sistemit informatik të integruar për shërbimet e licencimit në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme, që funksionon pranë portalit unik të shërbimeve qeveritare e-Albania, ose pranë çdo banke të nivelit të dytë, nëpërmjet formularit të faturës për arkëtim, i cili shkarkohet nga portali ose mund të disponohet pranë sekretariatit teknik, në Ministrinë së Zhvillimit Urban.

Kushte paraprake e kufizime

- 1. Individi/shoqëria/vlerësuesi i shoqërisë, që kërkon të licencohet, duhet të plotësojë kushtin që të mos jetë i dënuar nga organet gjyqësore për çështje që kanë lidhje me ushtrimin e aktivitetit profesional si vlerësues dhe të mos jetë në periudhën e ekzekutimit të një mase administrative të mëparshme, kundrejt licencës profesionale për vlerësim.
- 2. Individi/vlerësuesi i shoqërisë, që kërkon të licencohet, duhet të njohë dhe të angazhohet të zbatojë kushtet, rregullat dhe standardet e vendosura nga dispozitat në fuqi për ushtrimin e këtij profesioni dhe, në mungesë të tyre, t'u referohet standardeve evropiane të vlerësimit.
- 3. Individi/vlerësuesi i shoqërisë, që kërkon të rinovojë licencën, duhet të ketw shlyer te gjitha detyrimet tatimore.